



UNIVERSITETI I PRISHTINËS  
"HASAN PRISHTINA"  
UNIVERSITY OF PRISHTINA

Rr. Xhorxh Bush, Ndërtesa e Rektoratit, 10 000 Prishtinë, Republika e Kosovës  
Tel: +381 38 244 183 • E-mail: rektorati@uni-pr.edu • www.uni-pr.edu

Nr. Prot.: 1/994

Datë: 26/8/2016

Senati i UP-së, mbështetur në nenin 111 të statutit të UP, në mbledhjen e mbajtur me datë 27.07.2016 mori

**VENDIM**

**mbi afatin e provimeve të shtatorit dhe limitet e SEMS-it**

1. Afati i shtatorit 2016 do të organizohet në dy pjesë brenda muajit shtator (pilot projekt).
2. Afati i shtatorit është afat i rregullt. Në këtë afat studentët kanë të drejtë ti paraqesin të gjitha provimet e një viti akademik.
3. Në pjesën e dytë të afatit të shtatorit, studentët mund t'i nënshtrohen vetëm provimeve të cilat nuk kanë arritur t'i kalojnë në pjesën e parë të afatit të shtatorit.
4. Paraqitja e provimeve për afatin e shtatorit do të bëhet nga data 26 gusht deri më 31 gusht.
5. Mbajtje e provimeve të afatit të shtatorit fillon më 1 shtator dhe përfundon me 30 shtator.
6. Organizimi dhe mënyra e realizimit të provimit do të përcaktohet nga secila njësi akademike veç e veç.
7. Vendosja e notave në SEMS do të bëhet deri më 7 tetor.
8. Data e notës që do të vendoset në SEMS për të gjithë kandidatët të cilët i nënshtrohen provimit përkatës do të jetë data e mbajtjes së atij provim në pjesën e dytë të shtatorit.
9. Sistemi elektronik i menaxhimit të administratës së studentëve do të mbyllet për futje të notave më 7 tetor.

Vendimi t'i dorëzohet:

1. Menaxhmentit të UP-së,
2. Sekretarit të përgjithshëm të UP-së
3. Dekanëve të njësive akademike të UP-së,
4. Sekretarëve të njësive akademike
5. Zyrtarit Ligjor të UP-së
6. Arkivit të UP-së.



Prof. Dr. Marjan Dema

Rektor i UP-së